

28/08/2018

STATUTI I SHOQERISE

“Center for Environmental Research (CER)” SH.P.K.

KREU I

EMRI,OBJEKTI,KOHEZGJATJA,SELIA,ADRESA E FAQES SE INTERNETIT.

Neni 1

Emri.

1.1 Shoqeria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar emërtohet “ **Center for Environmental Research (CER)** shpk e cila më poshtë do të quhet shoqeria.

1.2 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj.

Neni 2

Objekti

2.1 Objekti I veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjisacionin shqiptarë do të jetë:

A- Vleresimin e ndikimit në mjedis, monitorim mjedisor, ekspertizë mjedisore, auditimit mjedisor, monitorim dhe vlerësimi i zhurmës në mjedis, laboratorë mjedisorë, projekte dhe vlerësimë në fushën akuakulturës dhe peshkimit.

B- Si dhe cdo aktivitet tjetër qe vecas ose me atë të përmendur më sipër do të konsiderohen të përshtatshme e me leverdi për zhvillimin e shoqërisë dhe që janë konform legjisacionit shqiptar.

Neni 3

Kohëzgjatja

3.1 Shoqeria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar.

Neni 4

Selia,adresa e faqes është internetit dhe adresa elektronike

4.1 Selia e shoqërisë është në Tiranë, Rruga “Muhamet Gjollesha”, P 2/3, Sh 2, K 3, Ap 7, Zona kadastrale 8260, Tirane.

- 4.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut të vetëm.
- 4.3 Shoqëria mund të hap ose të mbyll filiale, degë dhe /ose zyrë përfaqësimi në Shqipëri dhe jashtë saj.
- 4.4 Adresa e faqes së internetit është: d_arapi@hotmail.com
- 4.5. Adresa e internetit për qëllime të komunikimeve elektronike është: d_arapi@hotmail.com
- 4.6 Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendëqëndrimin, objektin e aktivitetit , të shfojë ortakë, të rrissë kapitalin sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar.

Kapitali themeltar fillestar I shoqërisë është 10,000 lekë.

Pjesmarja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tyre konkretisht:

Ortaku themelues Z. Dritan Arapi, zoterues i nje kuote me vlore te pergjithshme 10,000 leke I cili zoteron 100% të kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi I ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit.

Ky kapital mund të ndryshohet me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi I kapitalit

Kuotat janë lirisht të transferueshme tek personat e tretë nëse ortaku I vetëm vendos për këtë.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE.

Neni 8

Asambleja e përgjithshme e ortakëve.

8.1 Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga ortaku I vetëm.



8.2 Të gjitha vendimet e marra nga ortaku I vetëm regjistrohen në një register të vendimeve , të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen e të fshihen. Duke regjistruar në vecabit por pa u kufizuar vetëm në të,vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimitarisë.
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve.
- c) investimet.
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë.

Neni 9

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme.

9.1. Asambleja e Përgjithshme, e përbërë nga ortaku I vetëm , mblidhet në rastet e përcaktuara në ligj, nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme bëhet të paktën një herë në vit.

9.2. Mbledhja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose ortaku I vetëm I shoqërisë.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve , qe kerkojne një shumice te zakonshme , asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote , qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar , ajo mund te mare vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe marrin pjese ne mbledhje zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave .

Neni 11

Administratori.

11.1. Asambleja e Përgjithshme, e përbërë nga ortaku i vetëm cakton si administrator Z. Dritan Arapi.

11.2. Administratori I shoqërisë caktohet me një afat 5 vjet me të drejtë ripërtritje. Emërimi I administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

11.3. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar me të tretët në emër të shoqërisë në interes të saj në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji dhe Statuti i shoqërisë ua jep shprehimisht ortakëve.
- b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare.
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të regullt të dokumentave dhe librave kontabel të shoqërisë.



d) Raporton para Asamblesë së Përgjithshme lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,

e) Kryen detyra të tjera të caktuara me statut e me ligj.

Neni 12.

Procesverbalet e mbledhjeve të administratorëve.

12.1. Administratori kujdeset që të hapen libra të posacem e të mbahen procesverbale të:

- a) të gjitha takimeve të kryera nga administrator,
- b) të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të përbërë nga ortaku I vetëm si dhe mbledhjet me administratorin.

KREU IV

Viti finanziar- ekspertët.

Neni 13

Viti finanziar I shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti I parë fillon në datën e regjistrimit në QKB dhe mbaron me 31 Dhjetor.

KREU V

DIVIDENTET DHE KALIMI I FITIMEVE NE KAPITALIN THEMELTAR

Neni 14

14.1. Ortaku I vetëm miraton llogaritë vjetore dhe evidenton ekzistencën e fitimit.

14.2. Ortaku I vetëm përcakton fitimin e vitit finanziar pasi të jen zbritur më parë shumat për:

- a) rezervën ligjore ose të percaktuar nga ortaku I vetëm I shoqërisë.
- b) fonde të tjera të nevojshme.

14.3. Ortaku I vetëm përcakton dhe miraton dividentin.

Neni 15

Kalimi I fitimeve në kapitalin themeltar.

15.1. Me vendim Të ortakut të vetëm të shoqërisë, fitimet e pashpërndara , të cilat nuk do të përdoren për të paguar shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë, do të kalojnë në kapitalin e shoqërisë.

KREU VI

PRISHJA- RIORGANIZIMI I SHOQERISE.

Neni 16

Prishja dhe likujdimi.

16.1. Shoqëria prishet me vendim të ortakut të vetëm ose për arsyen e parashikuara me ligj.

16.2. Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin që ortaku I vetëm merr vendimin për prishjen e saj dhe caktimin e një ose disa likujdatorëve të cilët përgatisin raportin mbi gjëndjen e aktivitit dhe të pasivit të shoqërisë, me ndjekjen e operacioneve të likujdimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

16.3. Në përfundim të procesit të likujdimit ortaku I vetëm miraton bilancin përfundimtar financier dhe mbylljen e procesit të likujdimit.

16.4. Në përfundim të procesit të likujdimit pasi likujdimit të detyrimeve të kreditorëv , ortaku I vetëm mban pjesën e mbetur të kapitalit.

Neni 17

Riorganizimi I shoqërisë, Bashkim –ndarja.

Shoqëria mund të ndahet dhe bashkohet me vendim të ortakut të vetëm të saj në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin “ Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare”

Neni 18

Baza Ligjore

Shoqëria do zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me dispozitat e legjislacionit shqiptarë.

Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “ Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare” Kodit Civil si dhe cfarëdo ligji specifikë në Republikën e Shqipërisë.




Neni 19

Mosmarveshjet

Për mosmarveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtij statuti, si dhe cdo mosmarveshje që mund të lind ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ortaku i Vetëm I shoqerise

Dritan Arapi

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Dritan Arapi". The signature is fluid and cursive, with a distinct flourish at the end.